VENDIM
Nr. 131, datë 31.5.2022

MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "NRG POWER" SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e", nenit 10, pikat 1, 3 dhe 7, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 19, pika 1, germa "a', të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 830/6 prot., datë 27.5.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë 'NRG Power' sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "NRG Power" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 674 prot., datë 12.5.2022, ka paraqitur aplikimin për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë për furnizimin e energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal, si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- formatin dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat "a" dhe "b";
- dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat "a", "b" dhe "c";
- dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat "a", "b" dhe "d";
- dokumentacionin teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7, germat "c", "d", "f";

Rezulton se shoqëria nuk ka plotësuar një pjesë të konsiderueshme të dokumentacionit si vijon:

Formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1:

- germa "c" (të dhëna për aplikuesin). Shoqëria nuk ka plotësuar formularin me deklaratat përkatëse, në lidhje me njohjen me kuadrin ligjor dhe angazhimin për zbatimin e tij, etj.

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa "d" (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). Shoqëria nuk ka depozituar vërtetimet e prokurorisë dhe gjykatës për administratorin e saj;

- germa "e" (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse). Shoqëria nuk ka përcjellë në ERE strukturën e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të saj.

Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7:

- germa “a” (të dhëna për sigurimin e energjisë elektrike për furnizimin e klientëve). Shoqëria nuk ka paraqitur informacion sa kërkon kjo pikë e rregullores;

- germa “b” (kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj). Shoqëria “NRG Power” sh.p.k. ka depozituar në ERE një deklaratë nga një banke e nivelit të dytë, ku shprehet gatishmëria e mbështetjes së shoqërisë në kryerjen e aktiviteteve të tregtimit/furnizimit me energji elektrike për një vlerë totale të caktuar. Shoqëria duhet të përcaktojë shumën që vë në dispozicion të veprimtarisë së furnizimit;

- germa “e” (sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi). Shoqëria nuk ka përcjellë dokumentacion për sa kërkon kjo pikë e rregullores;

- germa “g” (dokumentacionin që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve). Shoqëria ka depozituar në ERE kontratën e qirasë së paluajtshme, të pashoqëruar me dokumentin përkatës pronësor, sipas përcaktimeve të dispozitave, në lidhje me objektin që jepet me qira;

- germa “h” (të dhënat për klientët dhe energjinë e furnizuar). Shoqëria nuk ka paraqitur informacionin përkatës në ERE në lidhje me këtë kërkesë të rregullores;

- germa “i” (niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët). Shoqëria nuk ka depozituar informacionin e kërkuar nga kjo pikë e rregullores.

- Në aplikimin e shoqërisë mungon një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit dhe po ashtu ajo nuk ka të përcaktuar në objektin e veprimtarisë së saj furnizimin e energjisë elektrike, veprimtari për të cilën kërkon të licencohet, ndaj vlerësohet që të mosfillojë procedura për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në mbështetje të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, shoqëria mund të paraqesë një aplikim të ri për licencim brenda 1 (një) muaji nga marrja e vendimit të ERE-s për mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit. Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohet e vlefshme për aplikimin e ri.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Në rast se shoqëria do të paraqesë një aplikim të ri, brenda 1 (një) muaji nga marrja e këtij vendimi, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria, së bashku me pagesën, do të konsiderohet i vlefshëm dhe për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti